



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark", Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë ____/____/2019

**SHPLLJE VETËM PËR NËPUNËS CIVILË, PËR LËVIZJE PARALELE DHE
NGRITJE NË DETYRË NË KATEGORINË E MESME DREJTUESE**

Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe të Kreut II, dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.3.2015 "Për Plotësimin e Vendeve të Lira në Kategorinë e Ulët dhe të Mesme Drejtuese", i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall Procedurat e Lëvizjes Paralele, Ngritjes në Detyrë në Shërbimin Civil, në pozicionin:

Ndihmës Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve - Kategoria e pagës II-b

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

Pozicioni i më sipërm, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për Procedurën e Lëvizjes Paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të Procedurës të Lëvizjes Paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet Procedurës së Ngritjes në Detyrë.

Afati për aplikim për Lëvizje Paralele është data: 12.04.2019

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Nd/Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve:

1. Të trajtojë, shqyrtojë, verifikojë rastet që përcillen nga Komisioneri i Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, Sekretari i Përgjithshëm ose në mënyrë direkte nga Avokati i Popullit, çështje që lidhen me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

2. Të monitorojë zbatimin e respektimin të të drejtave të fëmijëve në institucionet shtetërore (qendrat rezidenciale të përkujdesit shoqëror, qëndrat e zhvillimit, shkollat, kopshtet, çerdhet, spitalet, burgjet, komisaritet e policisë, etj).
3. Të vendosë dhe të forcojë bashkëpunimin me aktorët kryesorë rajonalë për të drejtat e fëmijëve.
4. Të marrë pjesë në fushata ndërgjegjësuese për të drejtat e fëmijëve në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, institucionet e pavarura e organizatat jofitimprurëse
5. Të monitorojë zbatimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Fëmijës”, si dhe të gjitha dokumentave të tjera ndërkombëtare e evropiane që kanë lidhje me mbrojtjen e respektimin e të drejtave të fëmijëve të ratifikuara nga Shteti Shqiptar.
6. Të propozojë rastet që mund të ndiqen me inisiativë, të bëra publike ne median e shkruar apo atë vizive.
7. Të kryejë inspektime pranë organeve të Administratës Publike qendrore apo vendore, si dhe në terren, dhe vendet ku ka sinjalizime/njoftime për shkelje të të drejtave të fëmijëve.
8. Të monitorojë zbatimin e Konventave të Ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, dhe të përgatisë informacione apo rekomandime për raportet periodike të monitorimit të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
9. Të hartojë rekomandime për çështje të veçanta apo edhe rekomandime legjislative në rastet kur vetë ligji apo akti nënligjor përbën premisë për shkeljen e të drejtave të fëmijëve.
10. Të marrë pjesë në grupet e hartimit të raporteve të veçanta dhe ndjekjen në vijim të rekomandimeve të dala gjatë hartimit të tyre.
11. Të jetë aktiv në mediat vizive dhe të shkruara me intervista apo edhe emisione të drejtpërdrejta mbi problematikat që lidhen me të drejtat e fëmijëve.
12. Të zbatojë me përpikmëri urdhërat, udhëzimet dhe porositë që i jepen në vijë vertikale, sipas shkallës hierarkike nga varet.
13. Të ushtrojë çdo kompetencë tjetër që i jepet nga eprori, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

I-Lëvizja Paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunës civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha Institucionet, pjesë e shërbimit civil (Kategoria II-b).

1. Kushtet për Lëvizjen Paralele dhe kriteret e veçanta për pozicionin Nd/Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve:

Kandidati për Lëvizjen Paralele duhet të plotësojë kushtet si më poshtë vijon:

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brënda së njëjtës kategori (Kategoria II-b)
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga Institucioni).
3. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mire”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

1. Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Sociale. Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat e marra në Universitetet jashtë vendit duhet të jenë të njehsuara nga Institucioni përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi).
2. Të kenë të paktën 5 vjet përvojë pune në profesion, në Administratën Publike.
3. Të zotërojë gjuhën angleze ose një gjuhë të BE-së (të vërtetuar me çertifikatë).
4. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

2. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) ose Zyrës së Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit, dokumentat si më poshtë vijojnë:

1. Letër motivimi për aplikimin për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail;
2. Jetëshkrim të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të cilin e gjeni në link: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>;
3. Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare;
4. Fotokopje të Librezës së Punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Fotokopje të Letërnjoftimit (ID);
6. Vërtetim të Gjendjes Shëndetësore;
7. Vetëdeklarim të Gjendjes Gjqësore;
8. Vlerësimin e fundit në punë;
9. Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.
10. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
11. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit brenda datës 12.04.2019

3. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Drejtorja e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e Lëvizjes Paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën kohë kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e Lëvizjes Paralele të përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk do të publikohet por administrohet nga Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) e cila do të njoftojë në mënyrë individuale, nëpërmjet adresës së e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve, (Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) brënda **3 (tre)** ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi merr përgjigje brënda **5 (pesë)** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

4. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët që konkurojnë për pozicionin e Nd/Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, do të vlerësohen në lidhje me:

1. Ligji nr. 76/2016 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Ligji nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.
3. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në datën 20 Nentor 1989 Lanzarote.
4. Ligji nr. 86/2013 Për Ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve “Për Procedurën e Komunikimit”.
5. Ligji nr. 9062, datë 8.05.2003 “Kodi i Familjes” i ndryshuar.
6. Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë për të Miturit”.
7. Ligji nr. 152/2013, “Për Nënpunësin Civil”, i ndryshuar.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Dokumentacionin e dorëzuar, deri në 40 pikë
2. Intervistën e strukturuar, deri në 60 pikë

Vlerësimi i dokumentacionit:

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, përvojën, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë, aftësitë, kompetencat në lidhje me përshkrimin e punës, sipas fushës së njohurive;
2. Eksperiencat e tyre të mëparshme;
3. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikët, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) do të shpallë fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit. Të gjithë kandidatët pjesmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042380334 ose në adresën:

Avokati i Popullit, Bulevardi “Zhan’ Dark” nr.2, Tiranë.

II. Ngritja në Detyrë

Vetëm në rast se pozicioni i publikuar në këtë shpallje, në përfundim të Procedurës së Lëvizjes Paralele, rezulton se është ende vakant, atëherë ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet Procedurës së Ngritjes në Detyrë.

Për procedurën e ngritjes në detyrë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunës civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një Institucion tjetër të Shërbimit Civil, që plotësojnë kushtet për Ngritjen në Detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin vakant.

1. Kushtet për Ngritje në Detyrë dhe kriteret e veçanta për pozicionin Nd/Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

Kandidati për Ngritje në Detyrë duhet të plotësojë kushtet si më poshtë vijon:

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda kategorisë III- a.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga Institucioni)
3. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit mirë ose shumë mirë;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

1. Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Sociale. Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat e marra në Universitetet jashtë vendit duhet të jenë të njehsuara nga Institucioni përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi).

2. Të zotërojë gjuhën angleze ose një gjuhë të BE-së (të vërtetuar me çertifikatë).
3. Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë në profesion, në Administratën Publike.
4. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

2. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) ose Zyrës së Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit, dokumentat si më poshtë vijon:

1. Letër motivimi për aplikimin për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail;
2. Jetëshkrim të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të cilin e gjeni në link: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteskrimi-standard>;
3. Fotokopje të Diplomës ose Diplomave të studimeve universitare;
4. Fotokopje të Librezës së Punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Fotokopje të Letërnjoftimit (ID);
6. Vërtetim të Gjendjes Shëndetësore;
7. Vetëdeklarim të Gjendjes Gjyqësore;
8. Vlerësimin e fundit në punë;
9. Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.
10. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
11. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit Brenda datës 17.04.2019

3. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Drejtorja e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e Ngritjes në Detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën kohë, kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk do të publikohet por administrohet nga Drejtorja e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) e cila do

të njoftojë në mënyrë individuale, nëpërmjet adresës së e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve, (Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) brënda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi merr përgjegje brënda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

4. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të vlerësohen kandidatët

Kandidatët që konkurojnë për pozicionin e Nd/Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve do të vlerësohen në lidhje me:

1. Ligji nr. 76/2016 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Ligji nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.
3. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në datën 20 Nentor 1989 Lanzarote.
4. Ligji nr. 86/2013 Për Ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve “Për Procedurën e Komunikimit”.
5. Ligji nr. 9062, datë 8.05.2003 “Kodi i Familjes” i ndryshuar.
6. Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë për të Miturit”.
7. Ligji nr. 152/2013, “Për Nënpunësin Civil”, i ndryshuar.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Vlerësimi me shkrim sipas fushës së njohurive, deri në 40 pikë
2. Intervista e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë
3. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikët, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) do të shpallë fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit. Të gjithë kandidatët pjesmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042380334 ose në adresën:

Avokati i Popullit, Bulevardi “Zhan’ Dark” nr.2, Tiranë.